

# HWDSB

Familje të dashura,

Në Bordin e Shkollës së Qarkut Hamilton-Wentworth (HWDSB), një nga prioritetet tona më të mëdha është që të sigurojmë që çdo ditë të gjithë nxënësit të arrijnë mirë në shkollë.

Për të forcuar procedurat tona për mungesat, ne do të vendosim **SafeArrival**, një sistem raportimi i mungesës së studentëve që do ta bëjë shumë të lehtë për ju të raportoni mungesat. Gjithashtu do të lejojë stafin e shkollës që të përgjigjet shpejt dhe hollësisht për të gjitha mungesat e pashpjegueshme. Qëllimi ynë është që të vazhdojmë të kemi të gjitha mungesat të justifikuara dhe të gjithë studentët çdo ditë të dihet se ku janë dhe se ata janë të gjithë të sigurtë.

Me **SafeArrival**, familjet raportojnë mungesën e fëmijës në njërin nga tre mënyrat:

1. Përdorni faqen e **SafeArrival**, [go.schoolmessenger.ca](http://go.schoolmessenger.ca). Herën e parë që përdorni faqen e internetit, zgjidhni **Regjistruhu** për të krijuar llogarinë tuaj. Zgjidh **i Pranishëm/e Pranishme (Attendance)** dhe **Raporto një Mungesë (Absence)**.
2. Duke përdorur pajisjen tuaj celulare, shkarkoni dhe instaloni **aplikacionin SchoolMessenger** nga Apple App Store ose Google Play Store (ose nga linket në [go.schoolmessenger.ca](http://go.schoolmessenger.ca)). Herën e parë që përdorni aplikacionin, zgjidhni **Regjistruhu (Sign Up)** për të krijuar llogarinë tuaj. Zgjidh **i Pranishëm/e Pranishme (Attendance)** dhe **Raporto një Mungesë (Absence)**.
3. Telefononi numrin pa pagesë 844-506-4350 për të raportuar një mungesë duke përdorur sistemin e automatizuar të telefonit.

Këto opsione janë në dispozicion 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë. Ju mund të raportoni një mungesë në në çdo kohë në të ardhmen.

Përveç kësaj, do të përdorim sistemin e njoftimit automatik të **SchoolMessenger** për të kontaktuar prindërit, fëmija i të cilëve mungon kur mungesa nuk është raportuar paraprakisht. Sistemi i automatizuar i njoftimit do të përpiqet të kontaktojë prindërit disa herë derisa prindërit të konfirmojnë dhe të shpjegojnë mungesën. Nëse ky sistem nuk do të mund të arrijë kontaktet e emëruara, më pas stafi i zyrës do të ndjekë çështjen.

Nëse raportoni mungesën e fëmijës suaj paraprakisht duke përdorur numrin pa pagesë të **SafeArrival**, faqen e internetit ose aplikacionin celular, ju NUK do të merrni këto njoftime.

**Duke filluar nga 23 prill 2019**, ju lutemi raportoni mungesat paraprakisht duke përdorur **SafeArrival** në vend të dërgimit të shënimeve me shkrim ose telefonatave/emailit në shkollë. Në këtë datë, stafi do të fillojë të përdorë njoftimet **SafeArrival** për t'ju bërë të ditur nëse fëmija juaj mungon (kur nuk e keni raportuar mungesën paraprakisht).

Nëse keni pyetje, ju lutemi flisni me zyrën e shkollës suaj ose me drejtoreshën/drejtorin. Gjeni më shumë informacion për **SafeArrival** në [bit.ly/safearrivalHWDSB](http://bit.ly/safearrivalHWDSB) dhe në faqen e internetit të shkollës suaj.

Faleminderit për durimin dhe bashkëpunimin tuaj ndërsa implementojmë këtë sistem të ri.